



## KOMUNIKATË

**7.11.2009**

Në mbledhjen e 54-të të kryesuar nga Kryetarja znj. Nesrin Lushta, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar akreditimet e radhës të vëzhguesëve për zgjedhjet e 15 Nëntorit. Poashtu, KQZ është informuar edhe për aktivitetet e përgjithshme të Operacionit të Votimit me Postë, si dhe për vizitën që një ekip i KQZ-së do të bëjë në Republikën e Malit të Zi.

Drejtoresha e Zyres për Regjistrimin e Partive Politike, znj. Miradie Mavriqi, i ka paraqitur KQZ-së procedimet e ZRPP-së për akreditimet e radhës të vëzhguesëve për zgjedhjet. Deri më 6 nëntor, ZRPP ka proceduar aplikacionet e vëzhguesëve të dhjetë (10) subjekteve politike, të tri (3) OJQ-ve vendore, të dy (2) Organizatave Ndërkombëtare, të katër (4) ambasadave dhe, të një (1) Zyreje Ndërlidhëse. Raporti përmban rekomandimet për akreditim të 1. 533 vëzhguesëve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e ka miratuar rekomandimin e ZRPP-së. Numri i vëzhguesëve të akredituar deri më sot, ka arritur në 21.109 vëzhgues.

Në mbledhjen e sotshme, Adnan Rrustemi ( Departamenti i Operacioneve Zgjedhore), e ka informuar KQZ-në për procesin e votimit përmes Postës me Jashtë. Z. Rrustemi, ka informuar KQZ-në se, me kohë janë dërguar pakot për 1806 aplikime të suksesshme, e në të cilat pako përfshihet i gjithë materiali i nevojshëm për zgjedhjet. Deri më sot, OVPP ka pranuar 575 zarfe të cilët nuk janë hapur. Departamenti i Operacioneve Zgjedhore, planifikon t'ua dërgojë të gjithë aplikantëve të suksesshëm një Letër Informuese para ditës së zgjedhjeve, në mënyrë që t'i informoj ata rreth mundësisë së raundit të Dytë për zgjedhjet për Kryetar të Komunave.

Z. Rrustemi, e ka informuar KQZ-së se, një ekip do të udhëtoj në Republikën e Malit të Zi për t'i pranuar Fletvotimet e Votuesëve që ndodhen në cilësinë e refugjatëve atje për shkak se, Posta e Kosovës dhe e Malit të Zi nuk kanë bashkpunim.